



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 206/4 prot.

Tiranë, më 10.03.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.19, datë 10.03.2026

MBI

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË INSPEKTIMIT TË THELLUAR, PËR
VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË GJATË APLIKIMIT TË INSTITUTIT TË
TRANSFERIMIT DHE INSTITUTIT TË PEZULLIMIT NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE DHE PARALAJMËRIMIN E
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me inspektimin e zhvilluar në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë regjistruar disa informacione të dërguara nga nëpunës civilë, pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilat parashtrihen pretendime për paligjshmëri të lejuara në administrimin e shërbimit civil gjatë zbatimit të institutit të transferimit të përkohshëm në detyrë dhe institutit të pezullimit në shërbimin civil.

Në të gjitha rastet, pas verifikimit paraprak të përmbajtjes së informacionit të administruar, Komisioneri i është drejtuar zyrtarisht institucionit të Drejtorisë së

Përgjithshme të Tatimeve, vënë për dijeni edhe Departamentin e Administratës Publike, si njësi përgjegjëse, duke evidentuar problematikat në administrimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në secilin rast, si dhe ka kërkuar të informohet në lidhje me veprimet e ndërmarra nga institucionin brenda një afati të arsyeshëm.

Në vijim të këtij procesi, Komisioneri ka konstatuar një mungesë të theksuar bashkëpunimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila nuk ka dhënë përgjigje për të informuar mbi masat e marra për trajtimin e problematikave të evidentuara në secilin rast nga Komisioneri. Kjo sjellje ka penguar ushtrimin efektiv të funksionit mbikëqyrës dhe zhvillimin normal të procedurës së verifikimit.

Në këto rrethana, duke vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme për shkelje të rregullave të administrimit të shërbimit civil, nga subjekte të ngarkuara nga ligji me detyra të veçanta, gjatë aplikimit të institutit të transferimit dhe pezullimit në shërbimin civil, në mbështetje të kompetencave ligjore, të parashikuara në pikën 1, të nenit 11; nenin 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar, si dhe nenit 2; nenit 14, germa a); neneve 16; 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, me Urdhrin nr. 26, (nr.206 prot.), datë 30.01.2026, Komisioneri ka urdhëruar kryejën e inspektimit të thelluar në këtë institucion, me objekt: “Zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë aplikimit të institutit të transferimit për punonjësit Gjergji Smokthina, Altin Demiraj, Asqeri Mirashi dhe institutit të pezullimit për punonjësit Besnik Seferaj, Edvin Gruçka dhe Agron Nuredinaj, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.

I. Baza ligjore e procesit dhe dokumentacioni i kërkuar

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar kryesisht verifikimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të institutit të transferimit për punonjësit Gjergji Smokthina, Altin Demiraj, Asqeri Mirashi dhe institutit të pezullimit për punonjësit Besnik Seferaj, Edvin Gruçka dhe Agron Nuredinaj, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Mënyra e organizmit të marrëdhënies së punësimit për personelin e administratës tatimore qendrore, rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, në përmbajtje të nenit 2 “Fusha e veprimit”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Më tej, sipas gurmës a), të pikës 1, të nenit 4 “Përkufizime”, të këtij ligji, jepet përkufizimi i termit “*Institucion i administratës shtetërore*” ku bën pjesë aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale.

Referuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i cili rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë, në nenin 13, të këtij ligji përcaktohet se: Administrata tatimore qendrore ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj, është institucion qendror, në varësi të Ministrit të Financave.

Sa më lart, rezulton se, administrata tatimore qendrore bën pjesë në listën e institucioneve të administratës shtetërore dhe si e tillë, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këto rrethana, bazuar në parashikimet e nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil edhe në administratën tatimore qendrore.

Procesi i inspektimit të thelluar ka filluar me paraqitjen në subjekt, të grupit të punës, të ngarkuar nga Komisioneri për kryerjen e inspektimit, me përbërje Luiseda Zhapa, me detyrë Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Zamira Mujali dhe Sabina Liço, me detyrë Inspektore pranë Drejtorisë Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, materializuar në procesverbalin e datës 03.02.2026, “Procesverbal për fillimin e procesit të inspektimit”, të nënshkruar nga grupi i punës dhe përfaqësuesja e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, znj. Blerta Guxha.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas objektit të inspektimit, njoftuar institucionit me shkresën nr. 206/1 prot., datë 30.01.2026 “Njoftim për fillimin e inspektimit të thelluar, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.

II. Metodologjia e përdorur për sistemimin dhe analizën e informacionit të mbledhur, në përputhje me objektin e inspektimit

Grupi i punës ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në vend të të gjitha akteve administrative që ndodhen në dosjen personale të nëpunësve, në të cilat dokumentohet procedura e ndjekur gjatë aplikimit të institutit të transferimit dhe të pezullimit në shërbimin civil, si dhe të çdo dokumenti tjetër të domosdoshëm për realizimin e objektit të inspektimit. Ky dokumentacion administrohet në arkivin e institucionit, si dhe në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Në zbatim të urdhrat të inspektimit, fillimisht u realizua një takim me Drejtoreshën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, gjatë të cilit u diskutua për objektin e

inspektimit, hapat që do të ndiqen nga inspektorët për realizimin e këtij objekti, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej t'i vihej në dispozicion grupit të punës, sipas urdhrit të inspektimit të dërguar pranë institucionit me shkresën nr. 206/1 prot., datë 30.01.2026, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Nisur nga natyra e problematikave të ngritura në informacionet e regjistruara pranë Komisionerit, gjatë inspektimit u verifikua materiali në dy drejtime: **a)** procedurat për rastet e transferimeve të nëpunësve, për nevoja të institucionit dhe **b)** procedurat për zbatimin e institutit të pezullimit, të parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Gjithë materiali që përmbanin këto raste, u analizua në mënyrë analitike, e mbi këtë bazë u hartuan edhe konkluzionet përmbledhëse, të përbashkëta për secilin grup çështjesh duke analizuar në mënyrë të detajuar gjetjet që u konsideruan të zgjidhura në kundërshtim me rregullat e administrimit të shërbimit civil, duke evidentuar parregullsitë; duke përcaktuar mënyrën si duhet trajtuar rasti, shoqëruar edhe me masat që duhen marrë në mënyrë të menjëhershme, për secilin prej tyre, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

III. Administrimi i informacioneve, veprimet e kryera dhe analiza e rrethanave të çështjes

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, pranë Komisionerit janë regjistruar **6** informacione nga punonjës të administratës tatimore, ku ngrihen pretendime për shkelje të rregullave të administrimit të shërbimit civil, nga subjekte të ngarkuara nga ligji me detyra të veçanta gjatë aplikimit të institutit të pezullimit dhe atij të transferimit në detyrë për nevoja të institucionit, të ndara sipas tipologjisë së problematikës në këtë mënyrë:

- në **3** raste transferim i përkohshëm në kundërshtim me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, dhe
- në **3** raste moszbatim i procedurës së parashikuar, në përfundim të afatit të pezullimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Për të gjitha këto raste u analizua hollësisht përmbajtja e veprimeve administrative dhe procedura e ndjekur për kryerjen e tyre, duke parashtruar në secilin rast rrethanat konkrete mbi shkeljet e pretenduara, si dhe veprimet që duhet të ndërmerren për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

III.a. Aplikimi i institutit të transferimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Përgjatë vitit 2025, Komisioneri ka administruar **3** (tre) informacione të dërguara nga punonjës të administratës tatimore, në përmbajtje të së cilave janë ngritur pretendime për transferim të përkohshëm në kundërshtim me kërkesat e ligjit të shërbimit civil, të analizuar në vijim të materialit sipas secilit rast.

✚ Ecuria e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për nëpunësin Gjergji Smokthina

Sipas dokumentacionit të administruar nga dosja personale e nëpunësit Gjergji Smokthina, rezulton se, me aktin nr. 2454 prot., datë 14.04.2022, “Emërim”, të DAP, në përfundim të procedurës së konkurrimit, kandidati fitues Gjergji Smokthina është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me klasë page II-1.

Në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit, me shkresën nr. 6345/23 prot., datë 05.01.2024, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, të DAP dhe shkresës nr. 593 prot., datë 12.01.2024, “Për transferimin e përhershëm të z. Gjergji Smokthina”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, nëpunësi është transferuar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, klasa e pagës II-1.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, me urdhrin nr. 314, datë 18.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është transferuar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve”, detyrë të cilën e ka ushtruar për më shumë se 6 muaj.

Nga shqyrtimi i aktit të sipërcituar konstatohet se, në akt nuk është përcaktuar periudha kohore për të cilën kryhet transferimi i nëpunësit, si dhe nuk është nxjerrë nga njësia përgjegjëse, që në rastin konkret është Departamenti i Administratës Publike.

Në vijim të analizës së marrëdhënies së punës për këtë punonjës, rezulton se përmes urdhrin nr. 153, datë 28.05.2025, “Për përfundimin e periudhës së zëvendësimit për shkak të ligjit”, të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, është vendosur rikthimi i nëpunësit në pozicionin e mëparshëm, atë të “Drejtorit të Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe në të njëjtën kohë me urdhrin nr. 154, datë 28.05.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ka ngarkuar përkohësisht punonjësin me ushtrimin e detyrave funksionale të “Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve”, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, deri në daljen e një urdhri të dytë. Gjithashtu, edhe në këtë akt nuk është përcaktuar periudha kohore për të cilën kryhet transferimi i nëpunësit, si dhe akti nuk është nxjerrë nga njësia përgjegjëse DAP.

Për këtë rast, pranë Komisionerit, është regjistruar shkresa nr. 339 prot., datë 18.02.2026, “Kthim përgjigje”, dërguar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet së cilës institucioni ka sqaruar se, mbështetur në ligjin nr.9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neni 28 i tij, germa d), urdhri nr. 154, datë 28.05.2025, i titullarit të institucionit, për caktimin e përkohshëm në detyrë të nëpunësit Gj. Smokthina është i ligjshëm, pasi është një akt nënligjor i brendshëm i nxjerrë nga titullari i institucionit që rregullon një marrëdhënie konkrete pune, duke arsyetuar se për më tepër, nëpunësi gëzon të njëjtën pagë.

✚ Ecuria e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për nëpunësin **Altin Demiraj**

Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga dosja e personelit të nëpunësit, rezulton se, me aktin nr. 5626 prot., datë 17.10.2024, “Emërim”, të DAP, në përfundim të procedurës së konkurrimit, kandidati fitues Altin Demiraj, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Vend sipas Industrive”, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatim Paguesve të Mëdhenj, klasa e pagës III-3. Në mbështetje të këtij akti, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka nxjerrë shkresën nr.107703/1 prot., datë 25.10.2024, për fillimin e marrëdhënieve financiare të nëpunësit në këtë pozicion pune.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, në datën 10.02.2025 nëpunësi është njohur me Urdhrin nr. 43, datë 06.02.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, me anë të të cilit ai është ngarkuar përkohësisht me ushtrimin e detyrave funksionale të “Inspektorit të Parë”, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, pranë DRT Elbasan.

Më tej, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka nxjerrë urdhërin nr. 174, datë 10.06.2025, “Për përfundimin e periudhës së zëvendësimit për shkak të ligjit”, me anë të së cilës ka rikthyer nëpunësin në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Kontrollit në Vend sipas Industrive”, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatim Paguesve të Mëdhenj. Në të njëjtën datë, me urdhrin nr. 175, datë 10.06.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, titullari i institucionit ka ngarkuar nëpunësin A. Demiraj përkohësisht në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit të të Ardhurave”, në Drejtorinë e Kontabilitetit të të Ardhurave, në DRT Tiranë.

Konstatohet se në dy rastet e transferimit të nëpunësit, nuk është përcaktuar një afat kohor për të cilin është bërë transferimi, si dhe akti nuk është nxjerrë nga njësia përgjegjëse, që në rastin konkret është DAP.

✚ Ecuria e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për nëpunësin **Asqeri Mirashi**

Grupi i punës këqyri aktet në dosjen e nëpunësit A. Mirashi dhe konstatoi se, me aktin nr.354 prot., datë 14.01.2021, “Emërim”, të DAP, në përfundim të procedurës së konkurrimit, nëpunësi është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, klasa e pagës III-b.

Për shkak të ristukturimit të institucionit, në zbatim të aktit nr. 19702 prot, datë 06.12.2023, “Për transferimin e përhershëm të Z. Asqeri Mirashi”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, nëpunësi A. Mirashi është transferuar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Kontrollit dhe Zyra e Monitorimit”, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Durrës, klasa e pagës III-3.

Më tej, në vijim të kërkesës së Drejtorit Rajonal Durrës, rregjistruar me nr. 1613 prot., datë 10.03.2025, me objekt: “Kërkesë për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nëpërmjet urdhërit nr. 110, datë 26.03.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, ka ngarkuar nëpunësin me detyrën “Specialist në Sektorin e Asistencës dhe Shërbimit të Tatim-Paguesve”, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatim Paguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

Konstatohet se, në aktin e sipërcituar “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë” nuk është përcaktuar afati kohor për të cilin është bërë transferimi, si dhe akti nuk ka dalë nga njësia përgjegjëse DAP.

Sa më lart, duke qenë se në të tre rastet e sipërcituara nëpunësit civilë, kanë të njëjtin objekt, pasi kundërshtohet akti i transferimit, nxjerrë nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjatë inspektimit, procesi i verifikimit të tyre është bashkuar për të vijuar më tej me analizën e praktikave të ndjekura nga institucioni, me qëllim evidentimin e shkeljeve të mundshme të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe propozimin e masave përkatëse për rregullimin paligjshmërisë së konstatuar.

III.a.1. Analiza juridike e rasteve objekt inspektimi dhe propozimi për marrjen e masave të nevojshme

Referuar rasteve të inspektuara të paraqitura më lart, në vijim do të analizojmë institutin e transferimit, duke ju referuar ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe aplikueshmërinë e këtyre kërkesave në aktet/urdhërat e nxjerra nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon në mënyrë shteruese të gjitha rregullat dhe procedurat në lidhje me institutin e rekrutimit; transferimit; pezullimi; disiplinës dhe vlerësimit të nëpunësve civil. Si rrjedhim, çdo akt i nxjerrë në përfundim të këtyre procedurave duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Konkretisht, në kreun VIII, neni 48, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

- a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;*
- b) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 viteve;*
- c) për arsye të përkohshme shëndetësore;*

...”.

Më tej, në VKM-në nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, pika 2, e kreut I, përcaktohet se:

“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil:

a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve;

b) Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve;

c) Për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, të përcaktuara nga komisioni kompetent në bazë të ligjeve në fuqi, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.”.

Ndërsa, sa i takon procedurës që duhet të ndiqet në këtë rast, në pikën 5, të këtij kreu, parashikohet se:

- *“... transferimi i përkohshëm, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kriterëve të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”...”.*

Në përfundim të afatit të transferimit, referuar pikës 12, kreu I, i VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016, nëpunësi kthehet në vendin e punës, me vendim të njësisë përgjegjëse duke respektuar afatet e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi.

Për rastet objekt inspektimi nga Komisioneri, aktet e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve:

- ✓ Urdhri nr. 154, datë 28.05.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, për nëpunësin Gjergji Smokthina;
- ✓ Urdhri nr. 175, datë 10.06.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, për nëpunësin Altin Demiraj;
- ✓ Urdhri nr. 110, datë 26.03.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, për nëpunësin Asqeri Mirashi,

sipas analizës së përmbajtjes të tyre, vërehet se nuk ndodhemi përpara rastit të transferimit të përkohshëm, sipas rregullimit që këtij instituti, i bëhet në nenin 48, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, pasi në këto raste **a) transferimi është kryer në një pozicion jashtë kategorisë ku ka emërimin e rregullt nëpunësi; b) nuk është përcaktuar**

afati kohor i transferimit; dhe c) në disa raste transferimet janë kryer në mënyrë të njëpasnjëshme dhe në tejkallim të afatit 6 mujor përgjatë 2 viteve.

Për më tepër, në pikën 5, të VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civile”, i ndryshuar, parashikohet se, transferimi i përkohshëm miratohet nga njësia përgjegjëse, që në rastin konkret është DAP-i, e cila i’a njofton nëpunësit këtë akt. Në të gjitha rastet objekt inspektimi nga Komisioneri, aktet e ndryshimit të pozicionit të punës për nëpunësit janë nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, duke mos respektuar rregullat e evidentuara më sipër.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Departamenti i Administratës Publike, në komunikimin që ka pasur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku për dijeni ka qenë edhe Komisioneri, në një rast ankese të një nëpunësi civil, duke sqaruar institucionin se, nuk kemi të bëjmë me një vendimmarrje të njësisë përgjegjëse (DAP), por të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, e për këtë arsye, referuar nenit 24 dhe pikës 1, të nenit 136, të Kodit të Procedurave Administrative, i ka dërguar rastin për shqyrtim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Gjithashtu, vlerësohet se në rastin e lëvizjes në detyrë të këtyre punonjësve, nuk jemi as përpara veprimit juridik të “zëvendësimit të zyrtarit”, në kuptim të kreut III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, pasi në nenet 12-15 të tij, përcaktohen rastet e zëvendësimit për shkak të ligjit, të zyrtarëve të administratës shtetërore në rast **a) mungese** apo **b) paaftësie afatshkurtër**.

Sa i takon qëndrimin të mbajtur nga institucioni në rastin e nëpunësit Gj. Smokthina, dërguar Komisionerit me shkresën nr. 339 prot., datë 18.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Kthim përgjigje”, vlerësojmë se, ligji nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cili është përdorur si bazë ligjore dhe si argument në këtë rast, ka për objekt organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit, të institucioneve në varësi të tyre, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore, që nxjerrin këto organe.

Në asnjë dispozitë të këtij ligji, nuk parashikohet një kompetencë e drejtuesit të një organi qendror për të vendosur me ndonjë prej akteve të sipërcituara për: **i)** transferimin; **ii)** ngarkimin apo **iii)** caktimin e përkohshëm të nëpunësve civile, nga një pozicion pune në një tjetër të tillë, duke anashkaluar rregullat e vendosura në ligjin për nëpunësin civil.

Për më tepër, neni 28, germa d), bën një rregullim të përgjithshëm mbi objektin dhe natyrën e akteve që mund të lëshojnë Kryeministri, Ministri apo Drejtoritë Qendrore, që lidhen me funksionet dhe përgjegjësitë e tyre të lindura/deleguara nga ligji, dhe jo mbi baza diskrecionale dhe pa referime në ligjin për nëpunësin civil.

Në vijim të arsyetimit, vlerësohet se aktet administrative të nxjerra nga titullari i institucionit, me të cilat është vendosur ndryshimi i pozicionit të punës për nëpunësit civil Gj. Smokthina, A. Demiraj dhe A. Mirashi, të analizuar në këtë material, në mbështetje të dispozitave ligjore të parashikuara në germën a), pika i) dhe ii), të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, duhet të konstatohen si akte absolutisht të pavlefshme nga vetë organi që i ka nxjerrë ato, që në këtë rast përkon me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe të rregullohen pasojat duke urdhëruar rikthimin e menjëhershëm të punonjësve në pozicionet e mëparshme të punës, ku ata kanë emërimin e rregullt në shërbimin civil.

Ndërkohë, pranë Komisionerit është regjistruar informacioni me nr.75 prot., datë 15.01.2026, me të njëjtin objekt ankimi si në rastet e analizuar më lart, dërguar nga avokat Artjon Beqiraj, përfaqësues i nëpunëses Dalina Teferiçi, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës”, në të cilin pretendohet se, nëpunësja është transferuar në mënyrë të padrejtë nga pozicioni i saj i punës.

Në vijim të trajtimit të këtij rasti, përmes shkresës me 75/1 prot., datë 29.01.2026, “Kërkesë për informacion në lidhje me shkresën nr. 75 prot., datë 15.01.2026, të administruar pranë Komisionerit, sa i takon procedurës së ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në rastin e transferimit të punonjësës Dalina Teferiçi”, Komisioneri ka kërkuar që të informohet në lidhje me qëndrimin që është mbajtur nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të zgjidhur ankesën e nëpunëses D. Teferiçi.

Më tej, gjatë inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, grupi i punës së KMSHC-së, ka kërkuar dhe administruar dokumentacionin në lidhje me ecurinë e marrëdhënies së punësimit të kësaj nëpunëseje, materializuar në procesverbalin e datës 05.02.2026, “Procesverbal për marrjen e dokumentacionit, për punonjësën Dalina Teferiçi”.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se marrëdhënia e punës për nëpunësen Dalina Teferiçi, pranë institucionit të DPT-së, ka përfunduar me aktin nr. 2002 prot., datë 30.01.2026, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, të titullarit të DPT-së, për shkak të largimit nga shërbimi civil si pasojë dhënies së masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, me vendimin nr. 13, datë 27.01.2026, të Komisionit Disiplinor.

Në vijim, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 1722/1 prot., datë 03.02.2026, me lëndë: “Kthim Përgjigje”, ka njoftuar njësinë përgjegjëse DAP dhe me shkresën nr. 2284/2 prot., datë 18.02.2026, protokolluar pranë Komisionerit me nr.75/2 prot., datë 20.02.2026, ka njoftuar këtë të fundit, për largimin nga detyra të nëpunëses Delina Teferiçi.

Sa më lart, në kushtet kur objekt i këtij verifikimi është procedura e transferimit të nëpunëses, e cila me aktin e largimit nga shërbimi civil ka përfunduar, atëherë trajtimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje nuk mund të vijojë në këtë material, për mungesë të objektit.

III.b. Aplikimi i institutit të pezullimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Pranë Komisionerit janë regjistruar **3** (tre) informacione të dërguara nga nëpunës civilë pjesë e administratës tatimore qendrore, në përmbajtje të së cilave ngrihen pretendime se, në përfundim të periudhës së pezullimit, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, *nuk ka ndërmarrë veprime për sistemimin e tyre në pozicionin ku kanë pasur emërimin e rregullt apo në një pozicion të barazvlefshëm me të*, sipas pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe pikës 17, të kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, *“Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi është njohur me problematikat e paraqitura, ka përfshirë trajtimin e këtyre rasteve në procesin e inspektimit të thelluar, filluar me urdhrin nr. 26, (nr.206 prot.), datë 30.01.2026, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në vijim paraqiten aktet e nxjerra gjatë aplikimit të institutit të pezullimit, në secilin rast.

✚ Veprimet e kryera gjatë aplikimit të institutit të pezullimit për nëpunësin Besnik Seferaj

Sipas dokumentacionit të këqyruar në dosjen personale të nëpunësit, rezulton se me aktin nr. 18944/1, datë 13.11.2024, *“Për pezullim nga shërbimi civil”*, të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nëpunësi Besnik Seferaj, është pezulluar nga shërbimi civil për periudhën kohore nga 13.11.2024 – 13.11.2025, (1 vit), me kërkesë të tij, për shkak të punësimit në sektorin privat.

Në përfundim të periudhës së pezullimit, me shkresën *“Për përfundimit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil”*, datë 10.10.2025, protokolluar pranë DPT-së me nr. 20182, datë 23.10.2025, nëpunësi i është drejtuar institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Departamentit të Administratës Publike, për ndërprerjen e afatit të pezullimit dhe rikthimin në detyrë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, rezulton se, DAP-i, me shkresën nr. 5290/1, datë 27.10.2025, *“Kërkesë për bashkëpunim në sistemimin në përfundim të periudhës së pezullimit”*, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të shprehet në lidhje me sistemimin e nëpunësit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

✚ Veprimet e kryera gjatë aplikimit të institutit të pezullimit për nëpunësin Edvin Gruçka

Referuar dokumentacionit në dosjen personale të nëpunësit Edvin Gruçka, me detyrë *“Drejtore i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve”*, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, rezulton se, ky nëpunës ka pezulluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil

me aktin nr. 1220/2 prot., datë 20.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, me kërkesë të tij, për një periudhë 2 (dy) vjeçare, duke filluar nga data 20.01.2024.

Më tej, nëpunësi në fjalë, me shkresën e datës 01.07.2024, me lëndë: “*Kërkesë për rikthimin në punë si nëpunës civil i nivelit drejtues në administratën tatimore*”, i është drejtuar institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Departamentit të Administratës Publike, për ndërprerjen e afatit të pezullimit dhe rikthimin në detyrë.

Sipas akteve të administruara nga Komisioneri, rezulton se Departamenti i Administratës Publike me anë të shkresës nr. 3532/3 prot., datë 09.10.2024, me lëndë: “*Kërkesë e përsëritur për sistemim në përfundim të periudhës së pezullimit*”, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të shprehet në lidhje me sistemimin e nëpunësit Edvin Gruçka, në një nga vendet aktualisht vakante të kësaj drejtorie por nga ana e institucionit nuk është kthyer përgjigje.

✚ Veprimet e kryera gjatë aplikimit të institutit të pezullimit për nëpunësin Agron Nuredinaj

Nga dokumentacioni i këqyrur, rezulton se nëpunësi Agron Nuredinaj, me detyrë “*Inspektor i Parë në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit*”, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, me aktin nr. 16609/1, datë 24.10.2023, “*Pezullim nga shërbimi civil*”, ka pezulluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil për një periudhë 2 (dy) vjeçare, duke filluar nga data 01.11.2023, me kërkesë të tij.

Më tej, me shkresën e datës 09.09.2025, protokolluar pranë DPT-së me nr. 17004 prot., datë 19.09.2025, nëpunësi i është drejtuar institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Departamentit të Administratës Publike, për ndërprerjen e afatit të pezullimit dhe rikthimin në detyrë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, rezulton se njësia përgjegjëse DAP, me anë të shkresës nr.4958/1 prot., datë 08.10.2025, “*Kërkesë për bashkëpunim mbi sistemimin në përfundim të periudhës së pezullimit*”, si dhe me anë të shkresës nr. 4958/3 prot., datë 05.11.2025, “*Kërkesë e përsëritur për bashkëpunim mbi sistemimin në përfundim të periudhës së pezullimit*”, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të shprehet në lidhje me sistemimin e nëpunësit Agron Nuredinaj, në një nga vendet aktualisht vakante të kësaj drejtorie, në të cilin ai i përmbush kriteret specifike të pozicionit të punës, por nga ana e institucionit nuk ka patur asnjë reagim.

III.b.1. Analiza juridike e rasteve objekt inspektimi dhe propozimi për marrjen e masave të nevojshme

Nisur nga sa u analizua më sipër, rezulton se në rastet e nëpunësve civilë, pjesë e administratës tatimore qendrore, objekt inspektimi, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nuk ka ndërmarrë veprime për sistemin e nëpunësve në përfundim të periudhës së pezullimit në pozicionin ku kanë pasur emërimin e rregullt

apo në një pozicion të barazvlefshëm me të, sipas pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar.

Në këtë dispozitë parashikohet se: *“Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësit regjistrohen në një listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse. Ata qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.”*

Po kështu, në pikën 17, të kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, *“Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Njësia përgjegjëse brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit vendos:

- a) rikthimin e nëpunësit civil në pozicionin e mëparshëm të punës, nëse ky pozicion është vakant, duke nxjerrë edhe aktin e rikthimit;*
- b) transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar nëpërmjet procedurave të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, duke nxjerrë aktin e transferimit;*
- c) regjistrimin e nëpunësit civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke njoftuar nëpunësin civil për regjistrimin në listë dhe arsyet e pamundësisë së zbatimit të procedurës së parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike”.*

Në këtë situatë, referuar pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe pikës 17, të kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, *“Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, i ndryshuar, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me marrjen e njoftimit për përfundimin e pezullimit, është e detyruar nga ligji që, të ndër marrë menjëherë veprime konkrete për sistemimin e nëpunësit në pozicionin ku ka qenë i emëruar, nëse pozicioni është ende vakant, apo transferimin e tij në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar në mënyrë të përhershme nëpërmjet procedurave të rekrutimit në shërbimin civil.

Në vijim të përmbylljes së procesit të sistemimit pas përfundimit të pezullimit, aktet ku materializohet procedura e ndjekur nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë DPT-së, duhet të përcillen pranë DAP-it, me qëllim që brenda afateve ligjore të përcaktuara, njësia përgjegjëse të nxjerrë aktin e rikthimit apo aktin e transferimit në një pozicion të shërbimit civil, për nëpunësin.

Në rast se, sistemimi i nëpunësit në një pozicion pune është i pamundur, atëherë, njësia përgjegjëse duhet ta regjistrojë atë në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të

ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke e njoftuar nëpunësin civil për regjistrimin në listë dhe arsyet e pamundësisë së sistemit në pozicionin ku ka qënë i emëruar apo transferimin në një pozicion tjetër të shërbimit civil.

Konstatohet se, nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në mbështetje të dispozitave ligjore të sipërcituara, janë ndërmarrë veprime konkrete për rikthimin në përfundim të periudhës së pezullimit vetëm për nëpunësin A. Nuredinaj, duke e emëruar me aktin nr. 4958/9 prot., datë 14.01.2026, “Për transferimin e përhershëm në përfundim të pezullimit”, të DAP-it, në pozicionin “Inspektor i Parë në Sektorin e Kontrollit për Biznesin e Vogël”, në Drejtorinë e Kontrollit nga Zyra në DRT Tiranë, klasa e pagës IV-1, për të cilin kanë filluar marrëdhëniet financiare me aktin nr. 736 prot., datë 14.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Ndërkohë, gjatë inspektimit në subjekt, grupi i punës konstatoi se me aktin nr. 20, datë 15.1.2026, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, ky nëpunës, menjëherë është transferuar përkohësisht në pozicionin “Drejtor Rajonal”, në Drejtorinë Rajonale Tiranë Durrës.

Ndërsa, për dy nëpunësit Besnik Seferaj dhe Edvin Gruçka, rezulton se, nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit për përfundimin e afatit të pezullimit për këta nëpunës dhe njoftimin e njësisë përgjegjëse DAP, me qëllim që njësia të nxirrte aktin e rikthimit për nëpunësit, në zbatim të pikës 17, të VKM-së nr.124, datë 17.02.2026, e ndryshuar.

Për rastin e nëpunësit Besnik Seferaj, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 567/1 prot. datë 05.02.2026, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 265 prot., datë 09.02.2026, ka informuar këtë të fundit se, pozicioni i punës “Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor”, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, klasa e pagës III-1, ku ka qënë i emëruar ky nëpunës, është dërguar pranë DAP-it, për t’u plotësuar përmes procedurave të konkurrimit.

Gjatë hartimit të materialit përmbyllës së procesit të inspektimit të thelluar në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Komisioneri u njoh me përmbajtjen e artikullit të publikuar në Gazetën Panorama, të datës 26.02.2026, në të cilin ngriheshin pretendime për emërimë në pozicionet drejtuese të administratës tatimore nëpërmjet procedurës së transferimit apo komandimit, në kundërshtim me parashikimet e legjisllacionit të shërbimit civil.

Nisur nga ky rast, Komisioneri vlerëson se nga ana e DPT-së dhe DAP-it, duhet të merren masa për të verifikuar mënyrën e plotësimit të pozicioneve të nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues në këtë institucion dhe në varësi të përfundimit të merren masa për të rregulluar situatën, duke njoftuar edhe Komisionerin në lidhje me këtë proces.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

V E N D O S A:

Të paralajmërojë institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të nxjerra për nëpunësit Gj. Smokthina, A. Demiraj dhe A. Mirashi, të evidentuara si më poshtë, si dhe të rikthejë nëpunësit në pozicionin ku ata kanë emërimin e rregullt në shërbimin civil:
 - Urdhëri nr. 154, datë 28.05.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për nëpunësin Gjergji Smokthina dhe kthimin e tij në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
 - Urdhëri nr. 175, datë 10.06.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, i Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, për nëpunësin Altin Demiraj dhe kthimin e tij në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Kontrrollit në Vend sipas Industrive në Drejtorinë e Kontrrollit Tatimor”, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj;
 - Urdhëri nr. 110, datë 26.03.2025, “Për ngarkim të përkohshëm në detyrë”, i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për nëpunësin Asqeri Mirashi dhe kthimin e tij në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Kontrrollit dhe Zyra e Monitorimit”, në Drejtorinë e Kontrrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me nëpunësit Besnik Seferaj, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier” dhe Edvin Gruçka, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve”, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, të njoftojë njësinë përgjegjëse DAP, për përfundimin e periudhës së pezullimit për nëpunësit.

Më tej, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, të vendosë brenda afati të parashikuar 10 ditor, për:

- rikthimin e nëpunësve civil në pozicionin e mëparshëm të punës, nëse ky pozicion është vakant, duke nxjerrë edhe aktin e rikthimit;
- transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar nëpërmjet procedurave të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, duke nxjerrë aktin e transferimit;
- regjistrimin e nëpunësve civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke njoftuar nëpunësin civil për regjistrimin në listë dhe arsyet e pamundësisë së zbatimit të procedurës së parashikuar në rastet e rikthimit apo transferimit.

3. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nën mbikëqyrjen e Departamentit të Administratës Publike, brenda afatit të vendosur nga Komisioneri, të verifikojë mënyrën e plotësimit të të gjitha pozicioneve drejtuese duke filluar nga niveli i ulët drejtues deri në nivelin e lartë drejtues, në Administratën Tatimore.

Në rast se konstatohet se këto pozicione nuk janë plotësuar në përputhje me kërkesat e institutit të rekrutimit në shërbimin civil, apo të mobilitetit në shërbimin civil, si rasti i transferimit apo lëvizjes paralele, të merren masa për të rregulluar ligjshmërinë, duke dërguar listën e pozicioneve të punës që rezultojnë vakante, pranë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, për të vijuar me procedurat e konkurrimit për plotësimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **2 muaj** nga marrja dijani për këtë vendim.

5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i inspektuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave, si dhe nëpunësit e përmendur në këtë vendim, duke i dërguar një kopje të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)